

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6698
E martë, 6 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Liz Truss, kryeministre e re e Britanisë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ME LEJEN E QEVERISË KURTI, BËRNABIQI QËNDROI NË VERI, KËRKOI FORMIMIN E ASOCIACIONIT

FAQE 4-5



Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka qëndruar të hënën në Mitrovicë të Veriut. Ajo është pritur nga përfaqësues të Listës Serbe, subjektit më të madh politik të serbëve të Kosovës, si dhe nga përfaqësues të institucioneve që punojnë në

sistemin e Serbisë. Ajo ka theksuar se vendi i saj do të vazhdojë të luftojë për popullin serb në Kosovë, duke thënë se është koha për ta formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë

AKTUALE



VAZHDON PROTESTA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE VAJZAVE NGA DHUNA F. 6

BISLIMI PËR DISKRIMINIMIN E SHQIPTARËVE NË LUGINË: KËTU SHIHET FYTYRA E VËRTETË E SERBISË F. 7

EKONOMI



"HARDH FEST" PËRMBYLL EDICIONIN, DHJETËRA MIJËRA PJESËMARRËS E VIZITUAN ATË F. 8

DALIN PAGAT PËR GUSHT, GRE-VISTËT KËRCËNOHEN ME PEZULLIM TË KONTRATAVE F. 8

KULTURË



PRESIDENTI I SHQIPËRISË E NDERON RITA ORËN ME TITULLIN "NAIM FRASHËRI" F. 8

SPORT

THAQI: DO TË PARAQITEMI DENJËSISHT NDAJ CLUJIT F. 10



VULA-POZHEGU: VLERA TOTALE E EKSPORTIT TË INDUSTRIËS SË DRURIT KAP SHIFRËN RRETH 230 MILIONË EURO

FAQE 7



KOSOVA S'KA VAKSINË KUNDËR ROTAVIRUSIT

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Liz Truss, kryeministre e re e Britanisë



Londër, 5 shtator - Liz Truss ka fituar garën në Partinë Konservatore, duke siguruar pozitën e lideres së kësaj partie dhe të kryeministres së re të Britanisë së Madhe. Ajo do të bëhet kryeministre të martën, më 6 shtator, pasi ta vizitojë Mbretëreshën Elizabeth II, e cila zyrtarisht do t'i kërkojë Truss që ta formojë qeverinë e re britanike. "Faleminderit që më besuat që të udhëheq dhe të shërbej për shtetin tonë. Do të ndërmarr veprime të guximshme që të gjithë ne të mund të tejkalojmë këto kohë të vështira, ta risitim ekonominë dhe ta tregojmë potencialin e Mbretërisë së Bashkuar", ka shkruar Truss në "Twitter" pak pas njoftimit për zgjedhjen e saj. Në garën partiake, Truss fitoi 57 për qind të votave. Pjesëmarrja në zgjedhjet e brendshme ishte e lartë, përkatësisht 82.6 për qind e anëtarëve partiakë votuan për udhëheqësin e ri. Zgjedhja e saj në krye të partisë udhëheqëse, Partisë

Konservatore, erdhi pas dy muajsh pasigurie, periudhë që është përshkruar me rritje të çmimeve të energjisë dhe me greva të dhjetëra mijëra punëtorëve. Në garë për kryeministrin e ri, përveç Truss, e cila ka shërbyer në pozitën e sekretares së Jashtme, ishte edhe ish-shëfi i Thesarit, Rishi Sunak. Ndërkaq, Sunak, pas disfatës në garën partiake, tha se Partia Konservatore është "një familje". "Tani duhet të bashkohemi prapa kryeministres së re, Liz Truss, teksa ajo drejton shtetin në këto kohë të vështira", ka shkruar ai në "Twitter". Truss do ta udhëheqë Britaninë, pasi paraardhësi i saj, Boris Johnson, dha dorëheqje në korrik për shkak të disa skandaleve. Kryeministrja e re britanike trashëgon një ekonomi që potencialisht po shkon drejt një recesioni të gjatë dhe do të duhet që menjëherë të ndërmarrë masa për ta zbutur krizën e kostos së jetesës që ka mbërthyer

Mbretërinë e Bashkuar. Për shkak të rritjes së çmimit global të gazit - që është shkaktuar pas pushtimit të paprovokuar rus të Ukrainës - faturat e energjisë për amvisëritë britanike u rritën në mbi 4 mijë dollarë në vit apo trefish më shumë sesa vitin e kaluar. Inflacioni ka arritur në mbi 10 për qind, për herë të parë që nga vitet '80. Qeveria britanike përballet me thirrjet që të ofrojë pako financiare për të ndihmuar miliona persona që t'i paguajnë faturat e tyre për ngrohje dhe rrymë me qëllim që ta kalojnë dimrin. Partia Laburiste në opozitë dhe kritikët e tjerë e kanë akuzuar qeverinë se "nuk ka vepruar" gjatë verës teksa pakënaqësitë sociale kanë shtyrë dhjetëra mijëra punëtorë të kompanive të trenave, porteve, postës, avokatëve dhe të tjerë që të hyjnë në grevë për të kërkuar paga më të mira pas rritjes së kostos së jetesës. Truss gjatë garës partiake kishte prezantuar politika që shteti të

ndërhyjë dhe të shkurtojë taksat. Ajo ka premtuar se do të veprojë "menjëherë" për të luftuar rritjen e çmimeve të energjisë, por nuk ka dhënë detaje sesi do ta bëjë këtë. Sunak, i cili e ka portretizuar veten si një ekonomist më realist, kishte thënë se ai do të ndërpriste përkohësisht Tatimin mbi Vlerën e Shtuar mbi faturat e energjisë. Ai ka insistuar se nuk do të zhyste shtetin në borxhe dhe se shkurtime të tjera tatimore do të duhej të bëheshin pasi inflacioni të vihej nën kontroll. Që të dy kanë shprehur admirimin e tyre për Margaret Thatcher, e cila ka qenë kryeministre e Britanisë në periudhën 1979-1990. Përdërisa ekonomia do të jetë çështja kryesore në muajt e parë të mandatit të kryeministrit të ri, pasardhësi i Johnsonit, Truss do të duhet të merret edhe me pozitën e Mbretërisë së Bashkuar në skenën ndërkombëtare, në dritë të pushtimit rus të Ukrainës, rritjes së prezencës së Kinës dhe tensioneve që po vazhdojnë me

Bashkimin Evropian lidhur me periudhën post-Brexit. Boris Johnsoni dha dorëheqje më 7 korrik, pasi qeveria e tij u përball me skandale etike. Si Truss ashtu edhe Sunak kanë qenë lojtarë kyç të kabinetit të Johnsonit, edhe pse Sunak kishte dhënë dorëheqje në shenjë proteste pas skandaleve. Johnson ka shërbyer si kryeministër në detyrë, por ai është kritikuar gjerësisht për dështimin që t'i përgjigjet krizës së energjisë. Johnson dhe Truss do të udhëtojnë për në Skoci për t'u takuar të martën me Mbretëreshën Elizabeth II, ku Johnsoni zyrtarisht do ta dorëzojë dorëheqjen dhe Truss do të ftohet që ta formojë qeverinë. Takimet e Mbretëreshës me kryeministrat tradicionalisht mbahen në Pallatin Bakingam në Londër. Por, monarkistja 96-vjeçare së fundmi është përballur me probleme shëndetësore dhe do të zhvillojë këtë takim në Skoci, ku zakonisht kalon pushimet e verës.

Tërmet vdekjeprurës në Afganistan

KABUL, 5 SHTATOR - Të paktën tetë persona kanë vdekur pasi një tërmet goditi gjatë natës verilindjen e Afganistanit, thanë zyrtarët mëngjesin e 5 shtatorit. Numri i viktimave mund të

rritet, tha për gazetaret zëdhënësi i provincës Kunar, Mawlavi Najibullah Hanif. Tërmeti prej 5.3 shkallësh të Rihterit goditi qytetin Xhalalabad, që gjendet në lindje të Afganistanit. "Tërmeti

i së dielës ka shkaktuar viktima në njerëz dhe dëme financiare", tha Hanif. Në qershor, një tërmet në Afganistan la të vdekur mbi 1 000 persona dhe shkatërroi disa vendbanime.



Kosova pa vaksinë kundër rotavirusit

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Vaksina kundër rotavirusit nuk është në Kalendarin e Obliguar të Vaksinimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (ISHPK). Sipas ekspertëve shëndetësorë, rotavirusi është një infeksion që përhapet lehtësisht te foshnjat dhe fëmijët. Ai mund të shkaktojë diarje të rëndë, të vjella, ethe, temperaturë dhe dhimbje barku.

Të prekurit me rotavirus mund të dehidratohen dhe të kenë nevojë për t'u shtruar në spital.

Arbnore Batalli Këpuska, pediatre në Klinikën Pediatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, thotë se rastet e fëmijëve me rotavirus janë të shpeshta, sidomos në sezonin e verës dhe dimrit. Sipas saj, të prekurit janë kryesisht fëmijë të moshës parashkollore. "Në Klinikën e Pediatrikë rastet me barkqitje dhe vjellje bëjnë pjesë në grupin e dytë të sëmundjeve sa iu përket patologjive të paraqitura te fëmijët", thotë Batalli Këpuska për "Radio Evropa e Lirë".

Në Repartin e Gastroenterologjisë në Klinikën Pediatrike gjatë këtij viti kanë qenë të shtrirë 814 fëmijë, prej këtyre 21 kanë qenë të konfirmuar me rotavirus.

Shefja e repartit, Teuta Hoxha Kamberi, thotë se jo të gjithë fëmijët me simptoma janë testuar për rotavirus për shkak të "ngarkesës në IKShPK me testimet për sëmundjen Covid-19.

Statistikat në shëndetësi, të publikuara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK),

tregojnë se shkalla e të infektuarve me rotavirus në Kosovë vitet e fundit ka shënuar rritje.

Në vitin 2019 shkalla e të infektuarve në 100 000 banorë ka qenë 15 për qind, më 2018 ka qenë 10.4 për qind, më 2017 ka qenë 9.2 për qind.

Ekspertët shëndetësorë thonë se infektimi me rotavirus mund të ndodhë nga çdo kontakt me lëngjet trupore të dikujt që është i infektuar, të tilla si teshtitja, apo edhe nga prekja e dorezave të derës ose lodrave që një fëmijë i infektuar i ka prekur. Mënyra më e mirë për mbrojtjen e fëmijëve kundër rotavirusit është vaksinimi, thotë Hamdi Ramadani, kryetar i Shoqatës së Infektologëve të Kosovës.

Sipas tij, ky infeksion, lehtë i transmetueshëm, shpesh kalon në epidemi, sidomos në stinën e dimrit.

Ai thotë se IKShPK-ja duhet ta bëjë të obligueshme vaksinën kundër rotavirusit sa më shpejt që është e mundur pasi, sipas tij, ajo është treguar shumë efektive në vendet ku aplikohet. "Dhënia e vaksinës duhet të ndodhë sa më herët që është e mundur... Kjo ul shkallën e sëmundjes dhe vdekshmërinë deri në 80 për qind të rasteve. Kosova, për fat të keq, nuk e ka të miratuar ende këtë vaksinë, por besojmë dhe shpresojmë që ta miratojë, pasi është edhe rekomandim i Organizatës Botërore të Shëndetësisë që të bëhet vaksinimi kundër rotavirusit", thotë Ramadani.



Dyvakina kundër rotavirusit janë të licencuara për foshnjat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në disa vende të Evropës, përfshirë disa të Ballkanit.

Në kalendarin e vaksinimit në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut kjo vaksinë është përfshirë në vitin 2019. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, vakcina kundër rotavirusit është aplikuar në 118 vende deri në vitin 2021. Të dyja dozat jepen me pika në gojën e fëmijës. Doza e parë e secilës vaksinë duhet të jepet para se fëmija të jetë 15-javësh. Fëmijët duhet t'i marrin të gjitha dozat e vaksinës kundër

rotavirusit para se t'i mbushin tetë muaj.

Sipas Qendrave për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve në ShBA (CDC), shumica e fëmijëve - rreth 9 në 10 - që marrin këtë vaksinë, mbrohen nga sëmundja e rëndë që mund të shkaktojë rotavirusi.

Programi i rregullt i vaksinimit në Kosovë hartohet nga IKShPK-ja dhe miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur IKShPK-në nëse planifikon përfshirjen e vaksinës kundër rotavirusit në kalendarin e obliguar

të vaksinimit, por deri në publikimin e këtij teksti nuk ka marrë përgjigje.

Në Ministrinë e Shëndetësisë thonë se në programin e zgjeruar të imunizimit në Kosovë janë të përfshira "vaksinat që parandalojnë sëmundjet më të përhapura dhe më të rrezikshme e që parandalohen përmes vaksinimit".

Në deklaratën me shkrim dhënë REL-it, nga ministria thonë se përfshirja e ndonjë vaccine të re në program "varet edhe nga propozimet që vijnë nga evidencat e bazuara në dëshmi shkencore rreth ndonjë sëmundjeje me rrezik të lartë si pasojë e mosvaksinimit".

Presidenti i Shqipërisë e nderon Rita Orën me titullin "Naim Frashëri"



Tiranë, 5 shtator - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se ishte kënaqësi të nderojë me titullin e lartë "Naim Frashëri"

artisten e mirënjohur Rita Ora për kontributin e dhënë në lartësimin e vlerave artistike dhe njerëzore përmes artit. "Mirënjohje për

aktivitetin dhe rolin e saj si ambasadore në çështje me ndjeshmëri të lartë kombëtare dhe globale. Shprehja konsideratën time

për të gjithë përkushtimin e saj për artin dhe kulturën. E inkurajova që të sjellë për botën, por edhe për kombin tonë, shembullin se si arti

vendos ura komunikimi në të gjitha dimensionet, bashkon njerëzit dhe shëron zemrat", ka shkruar Begaj në "Facebook".



Me lejen e qeverisë Kurti, Bërnabiqi qëndroi në veri, kërkoi formimin e Asociacionit

Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka qëndruar të hënën në Mitrovicë të Veriut. Ajo është pritur nga përfaqësues të Listës Serbe, subjektit më të madh politik të serbëve të Kosovës, si dhe nga përfaqësues të institucioneve që punojnë në sistemin e Serbisë. Ajo ka theksuar se vendi i saj do të vazhdojë të luftojë për popullin serb në Kosovë, duke thënë se është koha për ta formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë në Mitrovicë të Veriut, ku ka qëndruar për vizitë të hënën, se dëshiron të përçojë mesazhe të paqes, stabilitetit dhe tolerancës. Ajo ka thënë se autoritetet nga Serbia, përfshirë presidentin Aleksandër Vuçiq, do të jenë gjithmonë me komunitetin serb në Kosovë dhe ka shtuar se është e lumtur që ndodhet në Kosovë "në një moment kaq të vështirë". "Jam e lumtur që edhe pas provokimeve të fundit, të 31 korrikut, arritëm ta ruajmë paqen. Interesa të Republikës së Serbisë dhe të popullit serb janë paqja dhe stabiliteti", ka thënë Bërnabiq. Kryeministrja e Serbisë ka shtuar se vendi i saj do të vazhdojë të luftojë për popullin serb në Kosovë në mënyrë që përmirësimi i kushteve të jetesës të shihet në terren. Ajo ka theksuar se tani është koha për ta formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Gjithashtu, ai ka treguar se një gjë të tillë do ta përsërisë kudo që të shkojë - nga Mitrovica në Bruksel e Pekin. "Në këtë do të vazhdojmë të këmbëngulim çdo ditë", ka thënë Bërnabiq. Ajo shpreson se autoritetet e Kosovës do të jenë të përkushtuara ndaj dialogut dhe "gjetjes së një kompromisi", i cili, sipas saj, "do të jetë i nevojshëm për normalizimin afatgjatë të marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës". "Kjo është ajo që na duhet, jo për shkak të integritetit evropian, por për shkak të vetvetes, për shkak të asaj që duam me gjithë zemër, që është paqja dhe stabiliteti afatgjatë", ka thënë Bërnabiq. Ajo e ka vazhduar vizitën në Manastirin Banjska në Zvečan dhe aty ka thënë se "nuk ka bisedime të mëtejshme pa formimin e Asociacionit" sepse, sipas saj, ai "është baza për normalizimin e marrëdhënieve mes dy palëve". Në Leposaviq, komunë tjetër me

shumicë serbe në Kosovë, Bërnabiq ka përsëritur mesazhet për paqe dhe stabilitet. Bërnabiq ka arritur paraditen e së hënës në Mitrovicë të Veriut, ku është pritur nga përfaqësues të Listës Serbe - subjektit më të madh politik të serbëve të Kosovës - si dhe nga përfaqësues të institucioneve që punojnë në sistemin e Serbisë. Paraprakisht për ta pritur atë janë mbledhur edhe punonjës të institucioneve që financohen nga buxheti i shtetit serb. Ata mbanin në duar pankarta me fjalë përkrahëse, të tilla si: "Derisa e kemi [presidentin e Serbisë, Aleksandër] Vuçiq dhe Anën tonë, ne nuk i druhami asgjë". Kjo ishte vizita e parë e Bërnabiqit në Kosovë prej se u zgjodh kryetare e qeverisë serbe në vitin 2017. Më 2 shtator autoritetet e Kosovës lejuan vizitën e saj në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit për vizitat e ndërsjella të zyrtarëve politikë.

Në delegacionin e Bërnabiqit ishte edhe drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, dhe drejtori i Zyrës për Teknologji Informative dhe e-Qeverisje, Mihaillo Jovanović. "Kjo është një ditë e rëndësishme dhe e madhe për të gjithë ne", ka thënë Petković, duke komentuar vizitën e Bërnabiqit në Kosovë. "Falë presidentit [të Serbisë] Aleksandër Vuçiq dhe kryeminstres Ana Bërnabiq kemi arritur të investojmë shumë fonde dhe t'i fuqizojmë komunitetet serbe", ka shtuar ai. Vizita e Bërnabiqit në veri të Kosovës u zhvillua pasi Prishtina dhe Beogradi ranë dakord për shfuqizimin e dokumenteve hyrëse-dalëse të cilat Serbia ua lëshonte qytetarëve të Kosovës qysh në vitin 2011. Kur Qeveria e Kosovës ndërmori masa reciproke nga 1 gushti, disa serbë lokalë në veri u rebeluan dhe ngritën barrikada, për t'i penguar autoritetet në zbatimin e vendimit të tyre. Për shkak të rritjes së tensioneve, Prishtina zyrtare e shtyu zbatimin e atij vendimi për 30 ditë. Ndërkohë, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, dhe i dërguari amerikan për Ballkanin

Perëndimor, Gabriel Escobar, ndërhyjnë, duke biseduar me palët si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd. Dy vendet arritën marrëveshjen për heqjen e dokumenteve hyrëse-dalëse më 27 gusht. Megjithatë, Kosova nuk hoqi dorë nga vendimi i dytë, i cili ka të bëjë me reregjistrimin e veturave me targa serbe në targa RKS - Republika e Kosovës. Ky proces filloi më 1 shtator dhe do të zgjasë dy muaj. Beogradi pret negociata edhe për këtë çështje, përkatësisht propozon targa neutrale ndaj statusit të Kosovës, por këtë gjë Prishtina e refuzon. Vlerësohet se 10 000 vetura me targa si: KM (Mitrovicë e Kosovës), PZ (Prizren), UR (Ferizaj) e të ngjashme, të lëshuara nga Serbia, qarkullojnë në komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. Ato targa u hoqën në komunat në jug të Ibrit rreth 10 vjet më parë, në bazë të një marrëveshjeje midis Kosovës dhe Serbisë për lirinë e lëvizjes. Dy vendet janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Procesi ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara.

KDI-ja kërkon nga qeveria mosndërhyrje, nga gjyqësori efikasitet


PRISHTINË, 5 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka përcjellë me shqetësim përplasjet e fundit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial.

Rasti i dhunimit të një 11 vjeçeje ka risjellë vëmendjen te problemet me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë në Kosovë, ndër të cilat mosndëshkueshmëria dhe trajtimi joserioz i lëndëve të ndjeshme janë më akutet.

Ky rast edhe një herë veçse ka rikonfirmuar nevojën për reformimin e sistemit të drejtësisë në funksion të rritjes së nivelit të llogaridhënies dhe performancës së institucioneve të drejtësisë. "Megjithatë, KDI konsideron se qasja e Qeverisë së Kosovës ndaj kësaj situate, duke kërkuar shkarkime dhe dorëheqje të aktorëve të sistemit të drejtësisë, përbën ndikim në pavarësinë dhe punën e gjyqësorit. Kushtetuta e definojnë qartazi parimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit të pushteteve, andaj ndërhyrjet e

qeverisë në forma të tilla cenojnë standardet dhe parimet themelore të demokracisë kushtetuese. Për më tepër, legjislacioni parashih mekanizma të llogaridhënies ndaj gjyqtarëve e prokurorëve që janë aktualisht rruga e vetme për t'i thirrur në përgjegjësi lidhur me punën e tyre", është thënë në reagimin e KDI-së.

Më tej në reagim theksohet se në kohën kur vendi është në prag të inicimit të procesit të vetingut në drejtësi, raportet mes institucioneve të drejtësisë dhe ekzekutivit janë tejet të rëndësishme për përmbylljen me sukses të një procesi kaq të ndjeshëm e kompleks siç është vetingu. "Prandaj, KDI bën thirrje që qeveria t'i ndërpresë tendencat për ndërhyrje në punën e gjyqësorit, në anën tjetër edhe KGJK-ja dhe KPK-ja t'i përdorin mekanizmat e nevojshëm disiplinorë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me trajtimin joadekuat të rasteve", është theksuar në reagimin e KDI-së.



Bislimi për diskriminimin e shqiptarëve në Luginë: Këtu shihet fytyra e vërtetë e Serbisë



PRESHEVË, 5 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se do të insistojnë se çdo të drejtë që Serbia kërkon për qytetarët serbë në Kosovë, të njëjtat t'i kenë shqiptarët në Luginë të Preshevës. Gjatë vizitës zyrtare në Luginë të Preshevës, Bislimi ka thënë se letra e kancelarit gjerman Olaf

Scholz dhe presidentit francez Emmanuel Macron tregojnë se në këtë periudhë kohore, kur s'ka zgjedhje, të merren vendime të mëdha, që nënkupton arritjen e marrëveshjes finale me njohje reciproke. Ai ka thënë se në Luginë të Preshevës shihet fytyra e vërtetë e Serbisë, ku diskriminohen shqiptarët.

Bislimi ka shtuar se një temë me rëndësi në Bruksel do të jetë edhe garantimi i simetrisë dhe barazisë në të drejta mes qytetarëve shqiptarë në Luginë dhe atyre serbë në Kosovë. "Ka ardhur momenti kur mund t'i tregojmë gjithë Evropës si fytyra e vërtetë e Serbisë vërehet në Luginë meqë mendojmë që s'ka asnjë region në

Evropë ku popullata ende në vitin 2022 lufton për tekste mësimore për të drejta bazike, lufton për përfaqësim qoftë minimal nëpër institucione shtetërore", ka thënë Bislimi.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, në kuadër të vizitës së tyre në Luginën

e Preshevës, kanë shpërndarë edhe libra në Shkollën Fillore "Muharrem Kadriu" në fshatin Tërnoc të komunës së Bujanocit dhe në shkollën "Zenel Hajdini" në komunën e Preshevës. Për këtë vit shkollor qeveria ka ndarë mjete për blerjen e librave prej klasës së parë deri në të tetën për nxënësit në Luginë të Preshevës./kp

Shembulli i Shën Nënë Terezës ka inspiruar miliona njerëz anembanë botës



PRIZREN, 5 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti, ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe përfaqësues të ambasadave, nderuan lart dhe kujtuan të hënën simbolin e rëndësishëm të kombit shqiptar e të mbarë botës, Nënë Terezë, në 25-vjetorin e vdekjes. Në këtë aktivitet përkujtues u

tha se shembulli i Shën Nënë Terezës ka inspiruar miliona njerëz anembanë botës. U përkujtua me krenari gjithë vepra dhe misioni i saj që iu tregoi gjeneratave të reja që dashuria dhe respekti duhet të jenë udhërrëfyes në jetën tonë. Nënë Tereza ka ndërruar jetë më 5 shtator të vitit 1997 në Kalkutë të Indisë. Ishte humaniste e njohur shqiptare, fituese e çmimit Nobel për Paqe, kurse

më 19 tetor të vitit 2003 u shpall e bekuar nga Vatikani. Ajo ishte nënë kujdestare e 7 500 fëmijëve në 60 shkolla, ishte nënë që mjekonte 960 000 të sëmurë në 213 dispanseri, ishte e vetmja në botë që trajtonte 47 000 viktima të lebrozës në 54 klinika, kujdesej për 3 400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve, në 20 shtëpi pleqsh dhe kishte birësuar 160 fëmijë ilegjitimë e bonjakë.

Vazhdon protesta për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Me thirrjet "Shkarkoni gjyqtarët dhe prokurorët patriarkalë", "Asnjë më", "Gra armatosuni", "Nuk durojmë më", qindra qytetarë u mbledhën për herë të dytë brenda një jave në Prishtinë për ta shprehur revoltën ndaj dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave. Protestuesit fillimisht të hënën ndaluan para ndërtesës së qeverisë, policisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pastaj para Këshillit Prokurorial, ku kërkuan edhe shkarkimin e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi. "Ne do të vazhdojmë të jemi këtu derisa Prokuroria të na tregojë përfundimisht që është me viktimat e jo dhunuesin", tha një protestuese. Dorëheqjen e Munishit më 4 shtator e ka kërkuar ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila ka thënë se duhet të

merren veprime edhe ndaj "prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk po i kryejnë detyrat e tyre". Shkas i këtyre protestave u bë rasti i përdhunimit të një vajze 11 vjeçe më 27 gusht në një park të Prishtinës. Rastin e 11 vjeçes institucionet e drejtësisë po e trajtojnë në dy vepra të ndryshme penale. Veç masës së paraburgimit prej 30 ditësh për pesë të dyshuarit për dhunimin e të miturës, e njëjta masë është caktuar edhe për gjashtë të dyshuar të tjerë, të cilët, siç pretendohet nga institucionet e drejtësisë, në qershor kishin trafikuar, dhunuar dhe shfrytëzuar të miturën për shërbime seksuale. Protestuesit kanë disa kërkesa për Qeverinë e Kosovës. Ata kërkojnë legalizimin e përdorimit dhe shpërndarjes së gazit irritues për vetëmbrojtje, shkarkimin e



zyrtarëve që nuk e kanë kryer punën e tyre, krijimin e njësitit të specializuar për dhunë

seksuale në Policinë e Kosovës, futjen e lëndës së edukatës seksuale në shkolla dhe

sigurinë si dhe drejtësi e rehabilitim për të mbijetuarat e dhunës seksuale.



Çelet festivali "Etno Fest"

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Festivali "Etno Fest", që promovon kulturën, artin, traditën e trashëgiminë kulturore të vendit, është hapur me një program të pasur artistik. Pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjojnë performanca të shumta, ekspozita, shfaqje teatrale e të shijojnë ushqim tradicional në fshatin Kukaj. Në edicionin e dymbëdhjetë të

"Etno Fest" temë qendrore është 'Dashunia' për vlerat më të sinqerta të dashurisë për tokën, atdheun, familjen, kafshët dhe natyrën dhe kjo, sipas organizatorëve, do të jetë e shfaqet në programin e festivalit. Në hapje mori pjesë ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, i cili në fjalën e tij, ndër të tjera, tha se ky festival ka koncept të shkëlqyer që shërben si shembull se si

mund të transformohet një hapësirë për t'i shtuar vlerë kulturore dhe potencial turistik një vendi, duke ruajtur dhe promovuar traditat tona. "Etno Fest" edhe këtë herë e ka shndërruar fshatin Kukaj në një atraksion turistik. Festivali që do të zgjasë deri më 9 shtator mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kryetari i Malishevës viziton dy ferma të deleve

MALISHEVË, 5 SHTATOR - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli, si dhe këshilltari komunal, Halil Morina, i kanë vizituar të hënën dy ferma të deleve. Janë vizituar fermerët Brahim Sopaj në Janqist dhe Sahit Krasniqi në Astrazup, ndërsa qëllim i kësaj vizite ishte njoftimi me nevojat që kanë si kultivues të deleve dhe mundësia e mbështetjes për të

gjithë fermat që mbajnë kafshë të imta. "Unë ju përgëzoj juve që mbani dele, sepse i di vështirësitë që keni dhe djersën që derdhni për punën që bëni. Pikërisht për këtë, ne si komunë, jemi të interesuar të bisedojmë me ju dhe të marrim kërkesat e juaja, në mënyrë që t'i shikojmë të gjitha mundësitë për mbështetje të të gjithë kultivuesve të kafshëve të imta", ka thënë Kastrati. Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim

Rural, Sylë Dukolli, ka thënë se janë duke bërë përpjekje që kërkesat e fermerëve t'i bartin në hartimin e buxhetit për bujqësi në mënyrë që të gjejnë mundësi për përkrahje të zgjerimit të fermave dhe rritjen e numrit të krerëve të deleve. Fermerët Sopaj e Krasniqi e kanë falënderuar kryetarin Kastrati për vizitën dhe i kanë shprehur kërkesat dhe nevojat që kanë si dhe problemet që ata ballafaqohen në punën e tyre.



Vula-Pozhegu: Vlera totale e eksportit të industrisë së drurit kap shifrën rreth 230 milionë euro



Kryetarja e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit në Kosovë, Arieta Vula-Pozhegu, ka thënë se në vitin 2021, sipas të dhënave që kanë marrë nga Dogana e Kosovës për eksport për produktet dyer dhe dritare, mobilieri dhe përpunime të tjera nga druri, është shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak. Sipas saj, në vitin 2021 vlera totale e eksportit të drurit ka qenë rreth 230 milionë euro. Ajo ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zinxhiri i furnizimit ka pësuar ndryshime në lëndën e parë dhe në materialet që përdoren në industri si pasojë e rritjes së çmimeve në treg. "Furnizimet me lëndën e parë për përpunim kanë shënuar rritje në çmime prej 30-përqindësh deri në 100 për qind", ka treguar Vula-Pozhegu, e cila ka folur edhe për sfidat me të cilat po përballet kjo industri

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 SHTATOR -

"Epoka e re": Në çfarë gjendje është industria e drurit në Kosovë?

Vula-Pozhegu: Industria e përpunimit të drurit në Kosovë ka një gjendje stabile dhe është në rritje në përgjithësi. Tregu dhe fuqia blerëse në Kosovë pothuajse ka qenë e pandryshuar. Kërkesa për produkte jashtë vendit ka pasur rritje.

"Epoka e re": Kriza e pandemisë, energjisë elektrike dhe rrethanat gjeostrategjike, sa kanë ndikuar në industrinë tuaj?

Vula-Pozhegu: Kriza pas pandemisë dhe rrethanat e tjera gjeostrategjike kanë pasur ndikim dhe vazhdojnë të kenë

edhe tek industria e mobilierisë, në përgjithësi e përpunuesve të drurit. Zinxhiri i furnizimit ka pësuar ndryshime qoftë me mungesë në lëndën e parë dhe materialet që përdoren në industri qoftë me rritjen e konsiderueshme të çmimeve në treg. Furnizimet me lëndën e parë për përpunim kanë shënuar rritje në çmime prej 30-përqindësh deri në 100 për qind. Këto ndryshime në çmime dhe rritjet e paplanifikuara kanë ndikuar edhe tek industria në përgjithësi duke pasur rritje të çmimeve në produktet finale. Energjia, po ashtu, e paqëndrueshme, kohën e fundit me ndërprerje, është një ndër çështjet më serioze që ndikon negativisht te kompanitë prodhuese, duke sjell humbje të mëdha qoftë financiare, po ashtu edhe shtyrje të afateve të

dërgesave te klientët.

"Epoka e re": Sa është vlera e eksportit të drurit?

Vula-Pozhegu: Shoqata e Përpunuesve të Drurit në Kosovë zakonisht merr të dhënat nga Dogana për eksport për produktet siç janë dyer e dritare, mobilieri dhe përpunime të tjera nga druri. Kjo vlerë ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2020. Vlera totale e eksportit për vitin 2021 ka qenë rreth 230 milionë euro.

"Epoka e re": Sa i përket qeverisjes aktuale, si e konsideroni përkrahjen ekonomike nga kjo qeveri?

Vula-Pozhegu: Përkrahja nga qeveria ka si i përket zhvillimit ekonomik, mund të them se ka kushte dhe ambient të mirë të

bërit biznes. Kohën e fundit urojmë të jenë të përkohshme problemet me energjinë elektrike. Ndërprerja e energjisë elektrike është shumë serioze, sepse rrezikon veprimtarinë e kompanive, prandaj mendoj se fokusi duhet të jetë në sigurimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të furnizimit me energji elektrike. Shoqata e Përpunuesve të Drurit ka bashkëpunim me institucionet në veçanti me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe KIESA. Për aktivitetet tona rreth promovimit dhe rritjes së eksportit kemi gjetur përkrahjen nga Ministri e Industrisë.

"Epoka e re": Me çfarë projektësh aktualisht po merreni dhe sa keni arritur objektivat biznesore të

këtij viti?

Vula-Pozhegu: Aktualisht jemi me projektet 'Inkurajimi i grave për t'u inkuadruar në industrinë e përpunimit të drurit dhe mobilierisë', projekt i cili ka për qëllim të trajtojë rreth 50 gra/vajza në industrinë e përpunimit të drurit për dy muaj. Kjo do t'ua sigurojë praktikën dhe punësimin grave/vajzave te kompanitë anëtarë të Shoqatës së Përpunuesve të Drurit. Projekti ka mbështetjen edhe të USAID-it si donator përmes projektit Compete, po ashtu mbështetjen edhe të dy qendrave trajnuese të industrisë së drurit 'Shehu' dhe 'Dekoriti'. Ne kemi filluar me informim dhe shpallje, kështu që urojmë të ketë sa më shumë gra dhe vajza që do të lajmërohen për t'u trajnuar dhe punësuar në industrinë e drurit.

Një i vdekur dhe 22 raste të reja me Covid

Prishtinë, 5 shtator - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit është

konfirmuar një rast i një personi të vdekur si pasojë e infektimit me Covid-19. Kjo ministri ka

njoftuar se, pas 140 testimeve, janë konfirmuar 22 raste të reja me këtë virus. MSh-ja ka

njoftuar se në 24 orët e fundit janë shëruar 88 persona, ndërkaq raste aktive janë 589.



Bie vlera e euros në tregjet aziatike

FRANKFURT, 5 SHTATOR - Në tregjet aziatike vlera e euros ka rënë në 0.99 dollar për herë të parë që nga viti 2002. Më 5 shtator vlera e funtit britanik ka në vlerën më të ulët në dy vjet e gjysmë, përkatësisht në 1.14 dollarë. Monedha evropiane është në presion qëkur Rusia ndërpreu dërgesat me gaz për në Evropë përmes gazsjellësit

Rrjedha Veriore 1. Autoritetet ruse thanë se ndërprerjet po bëhen për shkak të rrjedhjes së naftës në turbinat e gazsjellësit. Autoritetet në Gjermani, shtet ku vjen gazi rus përmes këtij tubacioni, kanë thënë se ndërprerjet dhe reduktimi i furnizimeve të energjisë ruse janë përpjekje të Moskës për t'i

ndëshkuar shtetet perëndimore që kanë vendosur sanksione ndaj saj për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. Njoftimi për pezullimin e dërgesave të gazit natyror erdhi pasi ministrat e financave të shtatë shteteve më të industrializuara (G7) vendosën çmim tavan për naftën ruse.



Dalin pagat për gusht, grevistët kërcënohen me pezullim të kontratave

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës ka njoftuar të hënën se ka ekzekutuar pagat për muajin gusht për punëtorët që janë në grevë, duke shtuar se atyre duhet t'u pezullohen kontratat e punës.

Punonjësit e arsimit, administratës lokale dhe qendrore janë në grevë që nga 25 gushti me kërkesë për rritje pagash. "Për organizatat buxhetore që nuk kanë bërë përditësimin e listave dhe ku ka indikacione që ka pasur greva, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve do të bëjë konstatim të shkeljes së dispozitave ligjore të menaxhimit të financave publike lidhur me shpenzimin e parasë publike dhe Ligjit për Grevat", thuhet në njoftim.

Kjo ministri kishte njoftuar në fund të gushtit se pagat ishin ekzekutuar pjesërisht vetëm për ato institucione që kishin dërguar listën e punëtorëve që nuk ishin në grevë. "Përkundër afatit shtesë, disa organizata buxhetore as deri në ditën e sotme nuk kanë bërë përditësimin e listave për ta reflektuar kompensimin e saktë për orët dhe ditët e punuara, gjë që ka ndikuar në vonesë të ekzekutimit të pagave edhe për ata që kanë punuar", u tha në njoftimin për medie.

Duke u thirrur në Ligjin për Grevat, Ministria e Financave tha se punëdhënësi i grevistëve duhet t'ua pezullojë kontratën e punës. "Ky pezullim duhet të bëhet nga punëdhënësi, gjegjësisht përfaqësuesi i punëdhënësit



apo Zyrtari Kryesor Administrativ i secilës organizatë buxhetore. Andaj i takon secilës nga organizatat buxhetore që t'i përditësojë

listat e pagave dhe t'i dërgojë në Thesar ashtu që të reflektohet saktë kompensimi për punën e secilit", u tha në njoftim.

Grevistët kanë thënë se qeveria nuk mund t'i ndalë rrogat e tyre për aq kohë sa ata janë në grevë, por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar javën e kaluar se nuk mund të paguhen personat që nuk punojnë. Sindikatat që janë në grevë po kërkojnë nga 100 euro shtesë për punëtorë deri në hyrjen në fuqi të Projektligjit për Paga që, së fundmi, është hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në fundjavë qeveria ka prezantuar një pako të ndihmës, në të cilën ka paraparë ndihmë prej 50 eurosh për sektorin publik. Sipas Projektligjit për Paga, pasi i njëjti të ketë kaluar në të gjitha procedurat, do të hyjë në fuqi tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

'Hardh Fest' përmbyll edicionin, dhjetëra mijëra pjesëmarrës e vizituan atë



EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

RAHOVEC, 5 SHTATOR - Edicioni më i suksesshëm i festës së vjeljes së rrushit, festivalit "Hardh Fest", është përmblyllur për këtë vit.

Për tri ditë rresht, më 2, 3 dhe 4 shtator, qytetarë nga mbarë Kosova dhe jashtë saj u kënaqën me aktivitetet e shumta ditore dhe koncertet e tri netëve që kishin përgatitur për sivjet organizuesit e festivalit "Hardh Fest".

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se festa e rrushit që dikur shënohej në mënyrë simbolike nga vreshtarët lokalë të Rahovecit, tani është shndërruar në një

festival madhështor, shumëngjyrësh e rekreativ, që mbledh të rinj e të reja nga e gjithë bota, për t'u kënaqur e dëfryer, për të parë e shijuar, sigurisht përjetime të shumta e të paharruara nga oferta e pasur dhe e shkëlqyer që përmban e përfaqëson festa "Hardh Fest", por edhe për ta njohur vreshtarinë e verën rahovecase, sikurse edhe vlerat e trashëgimisë sonë të pasur kulturore e natyrore. "Falënderoj këshillin organizues të edicionit të sivjetmë, në krye me drejtorin ekzekutiv të festivalit, Agron Sokoli, për performancë të shkëlqyer, përkushtimin e madh në punë dhe planifikimin e mirë e të menduar deri në detajet më

të imëta. Po ashtu, falënderoj edhe organet e rendit dhe ligjit, policinë, sigurimin dhe ekipin e QKMF-së, njësinë e zjarrfikësve si dhe ekipe e individë, që kryen detyrat e veta me përgjegjësi të lartë dhe me vigjilencën e treguar mirëpritën dhjetëra mijëra pjesëmarrës, vizitorë e turistë të shumtë, pa u shënuar as edhe incidenti më i vogël", ka thënë Latifi.

Ai ka shtuar se "Hardh Fest"-i tashmë është shndërruar në një ngjarje të madhe kulturore që i sjell krenari të madhe komunës së Rahovecit.


Latifi ka thënë se mbështetja e komunës së Rahovecit për "Hardh Fest"-in vetëm se do të rritet në vitet e ardhshme.

ATK-ja shënon rritje të të hyrave për 22 për qind në muajin gusht

PRISHTINË, 5 SHTATOR - 88.5 milionë euro më shumë të hyra në Administratën Tatimore të Kosovës në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë regjistruar sivjet, ka njoftuar të hënën ATK-ja. "Trend i mirë i inkasimit të të hyrave ka vazhduar ta karakterizojë edhe

muajin gusht, i cili ka shkuar përtej planifikimeve të bëra, duke u realizuar 33.4 milionë euro më shumë se plani ose 7.4 për qind. Përderisa kjo performancë ngrit të hyrat e përgjithshme në 487.2 milionë euro, që nëse ngrehim paralele krahasimi me periudhën e njëjtë

të vitit të kaluar, shohim se kemi rritje për 88.5 milionë euro apo 22.2 për qind", ka njoftuar ATK-ja, duke theksuar se do të vazhdojë të mbetet e përkushtuar për përmbushjen e mandatit kryesor për mbushjen e arkës së shtetit nga inkasimi i tatimeve të bizneseve.



Si dhe ku ndryshon loja e madhe e naftës



Nga Federico GIULIANI
"Il Giornale"

Për të kuptuar se çfarë do të ndodhë me industrinë globale të naftës, dhe me çfarë pasojash do të përballlet Evropa në të ardhmen e afërt, është e nevojshme të shohim se çfarë po ndodh në Lindje. Në fakt pikërisht atje do të zhvillohet loja e madhe e naftës ruse, e goditur aktualisht nga sanksionet e BE-së, por vetëm pjesërisht, në pritje të goditjes përfundimtare të planifikuar për në fund të këtij viti.

E detyruar ta identifikojë Azinë si rajonin e saj të ri tregtar kryesor pasi u izolua nga Evropa, Rusia i ka forcuar marrëdhëniet e saj me partnerët e vjetër dhe të rinj lokalë. Në rast se marrëdhëniet gjithnjë e më të forta ekonomike midis Moskës dhe Pekinit nuk janë befasuese, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për aksin e ri ekonomik Moskë-Nju Delhi. Ndërkohë, pavarësisht se e kanë dënuar Rusinë për luftën në Ukrainë, Japonia dhe Koreja e Jugut vazhdojnë të blejnë naftë nga Kremli. Ashtu si Tajvani, që kohët e fundit u vendos në qendër të vëmendjes ndërkombëtare për vizitën e Nancy Pelosi në ishull dhe reagimin e ashpër të Pekinit.

Pra, Perëndimi dhe partnerët e tij, përfshirë ata në Azi, janë unanimitë në akuzën e tyre ndaj Moskës për sulmin ndaj Kievit dhe shkaktimin e një konflikti të përgjakshëm. Por njëkohësisht

ka nga ata që duket se nuk kanë ndërmend të sakrifikojnë sistemet e tyre ekonomike dhe prodhuese, duke e privuar plotësisht veten nga lidhjet me rusët.

Duke lënë mënjanë SHBA-në, për të cilën ndikimi i embargos ndaj naftës ruse do të ketë një efekt dukshëm të kufizuar në krahasim me atë që do të ndodhë në Kontinentin e Vjetër, është interesante të përqendrohet vëmendja tek India, Koreja e Jugut, Japonia dhe Tajvani. Pa harruar edhe Kinën, e cila edhe pse nuk është pjesë e aleancës perëndimore, po kryen lëvizje tregtare që do të prekën sektorin botëror të naftës.

Nëse çmimi i naftës ka rënë kohët e fundit, kjo ka ndodhur sepse India dhe Kina e kanë rritur blerjen e naftës së papërpunuar nga Rusia, dhe në të njëjtën kohë kanë reduktuar blerjen e naftës nga vendet e treta. Kjo gjë i ka detyruar prodhuesit e tjerë, përfshirë Arabinë Saudite, që të ulin çmimet e tyre.

Le të marrim tani rastin e Indisë, ku Moska po e dominon tregun vendas të naftës, madje duke tejkuluar edhe peshën që kanë vendet saudite dhe të OPEC sa i përket blerjes së burimit të çmuar të energjisë. India, vendi më i madh importues i naftës në botë (85 për qind e naftës importohet nga jashtë), ka gjetur një partner të përsosur tek Rusia. Sipas asaj që raporton Bloomberg, në 3-mujorin e dytë të këtij viti, pra nga prilli në

qershor, qeveria indiane e ka blerë naftën ruse me një çmim më të ulët se ai që e ofron Arabia Saudite. Ndërkohë, Nju Delhit iu bë një tjetër ofertë për një sasi të madhe naftë ruse me një çmim të ulur deri në 19 dollarë për fuçi. Një muaj më vonë, në qershor, Rusia ia kaloi Arabisë Saudite duke u bërë furnizuesja e dytë më e madhe e naftës në Indi pas Irakut. Pra meqë lufta në Ukrainë e detyroi Rusinë të gjente tregje të reja në të cilat ta eksportoje naftën e saj, me çmime më të volitshme, India përfitoi nga situata duke u bërë si një nga klientët kryesorë të Moskës. Në këtë mënyrë, ajo garantoj një efekt pozitiv në ekonominë e saj. Ndërkohë, Kremli është bërë furnizuesi më i madh i naftës edhe për Kinën. Sipas të dhënave të bëra publike nga Administrata e Përgjithshme Doganore e Kinës, në korrik, rafineritë e pavarura të vendit komunist i rritën sasinë e naftës së blere me çmim të ulur nga Moska, duke reduktuar importet nga furnizuesit rivalë si Brazili dhe Angola.

Në përgjithësi, importet e karburanteve fosile të Kinës nga Rusia vazhdojnë që të rriten. Pekini bleu naftë bruto dhe gaz natyror të lëngshëm (LNG) për të katërtin muaj radhazi, duke shënuar rritje vjetore respektive prej 7.6 për qind (në rreth 7.14 milionë tonë) dhe 20.1 për qind, duke kaluar 400.000 ton.

Importet kineze të naftës nga Rusia që nga fillimi i këtij vitit arritën në 48.45 milionë tonë, 4,4

për qind më shumë se një vit më parë, por mbetet ende pas atyre të Arabisë Saudite, e cila e furnizoi Kinën 49.84 milionë tonë, ose 1 për qind më pak se një vit më parë. Kësisoj, falë Kinës, kompania ruse e naftës Rosneft është bërë një nga kompanitë më të mëdha në botë, ndërsa kërkesa e Indisë për naftën ruse e ka lejuar Moskën të rrisë eksportet e naftës së papërpunuar në Nju Delhi nga rreth zero në 1 milionë fuçi në ditë.

Ndaj ka ardhur koha të përmbledhet strategjia që ka në mendje Evropa. Embargoja e BE-së për importet e naftës ruse që vijnë përmes rrugëve detare, do të hyjë në fuqi midis dhjetorit dhe janarit. Në qershor, Këshilli miratoi një paketë prej 6 sanksionesh ku ndër të tjera "ndalon blerjen, importin apo transferimin e naftës bruto dhe produkteve të caktuara të naftës nga Rusia në BE".

Por këto kufizimet do të hyjnë gradualisht në fuqi: brenda 6 muajve për naftën bruto dhe brenda 8 muajsh për produktet e tjera të rafinuara të naftës. Ndërkaq, ekziston një përjashtim i përkohshëm për importet e naftës së papërpunuar që vjen përmes linjave tokësore drejt vendeve anëtare, të cilat për shkak të vendndodhjes së tyre gjeografike, vuajnë nga një varësi specifike nga furnizimet ruse dhe nuk kanë alternativa të mundshme.

Sipas Brukselit, deri në fund të

vitet këto kufizime do të mbulojnë gati 90 për qind të importeve të naftës ruse në Evropë, duke ulur ndjeshëm fitimet e Ruisë nga ky sektor. Më pas BE-ja do të duhet të kërkojë furnitorë të rinj të aftë të zëvendësojnë Kremlinin (nga Nigeria në Angola nëpërmjet Kamerunit).

Ndërkohë në Azi, partnerët kryesorë perëndimorë vazhdojnë të importojnë naftë nga Rusia. Siç theksoi Asian Nikkei Revieë, në 5 muajt pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, Japonia, Koreja e Jugut dhe Tajvani importuan një total prej 5.5 miliardë dollarësh lëndë djegëse fosile nga Moska.

Kjo tregon varësinë e madhe të këtyre vendeve nga lëndët e para ruse, së cilës është pothuajse e pamundur që t'i jepet fund. Qendra për Kërkime për Energjinë dhe Ajrin e Pastër, vlerëson se Japonia importoi 2.6 miliardë dollarë qymyr, naftë dhe gaz rus midis 24 shkurtit dhe 31 korrikut. Koreja e Jugut ka rreth 1.7 miliardë, ndërsa Tajvani 1.2 miliardë dollarë importe në të njëjtën periudhë.

Kështu, Seul, Tokio dhe Taipei kanë kontribuar me rreth 1 miliardë dollarë në muaj në buxhetin federal të Ruisë. "Kur të hyjnë në fuqi sanksionet e vendeve të BE-së për qymyrin dhe naftën ruse në fund të këtij viti, vendet e Azisë Lindore do të mbeten në thelb klientet kryesorë të lëndëve djegëse fosile ruse"- thotë Lauri Myllyvirta, studiuesi kryesor i institutit kërkimor CREA.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Thaqi: Do të paraqitemi denjësisht ndaj Clujit

Kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, pas fitores në Superligë ndaj Prishtinës, do të përballet me skuadrën Clujit të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri". Mbrojtësi Armend Thaqi ka premtuar se do të japin maksimumin që të paraqiten denjësisht në këtë ndeshje. "Do të përgatitemi në maksimum për t'u paraqitur në mënyrë të denjë dhe normalisht se do të jetë e vështirë sepse dihen kualitetet e ekipit të Clujit", ka thënë Thaqi

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Armend Thaqi është ndër lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës në vitet e fundit dhe motori kryesor i skuadrës së Ballkanit. Mbrojtësi i krahut të djathtë të hënën për "Epokën e re" ka folur për ndeshjen e radhës që skuadra kampione e Kosovës e zhvillon në grupet e Ligës së Konferencës. Siç dihet, Ballkani e ka shkruar historinë duke u bërë skuadra e parë që arrin një sukses të tillë, derisa Thaqi premtonte maksimumin të enjten përballë skuadrës së Clujit. "Ne jemi të

kënaqur me të arriturat historike që kemi bërë, por nuk jemi ndalur së punuari që sukseset t'i vazhdojmë edhe në vazhdim. Të enjten e kemi ndeshjen debutuese në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës dhe do të përgatitemi në maksimum për t'u paraqitur në mënyrë të denjë dhe normalisht se do të jetë e vështirë sepse dihen kualitetet e ekipit të Clujit. Ne nuk do të dorëzohemi dhe do të mundohemi të japim më të mirën", ka thënë Thaqi. Zëvendëskapiteni i Ballkanit bëri asistimin në golin e vetëm që e shënoi Albion Rrahmani në përballje me Prishtinën (0-1). Lidhur me fitoren që kampionët e



arritën të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri", Thaqi ka thënë se ishte e merituar dhe synim i skuadrës nga Suhareka është ta mbrojnë titullin. "Jemi shumë të kënaqur me fitoren në derbi kundër Prishtinës. Është një fitore shumë e merituar. Përderisa jemi po grupi i njëjtë që u shpallëm kampion, normalisht edhe këtë stinor synojmë ta mbrojmë

titullin, edhe pse do jetë shumë e vështirë sepse është vetëm fillimi", ka thënë Thaqi.

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll në këtë muaj zhvillon edhe dy ndeshje në Ligën e Kombeve kundër Irlandës së Veriut më 24 shtator dhe tri ditë më vonë ndaj Qipros. I pyetur se a pret ftesë nga përzgjedhësi Alain Giresse pas formës së jashtëzakonshme që po kalon, Thaqi është përgjigjur: "Sa i përket ftesës është selektori që vendos kush e meriton e kush jo, mirëpo gjithmonë kur është e nevojshme jam i gatshëm të kontribuoj për vendin tim".

Liga e Kampionëve fillon me derbin PSG - Juventus

Paris, 5 shtator - Gara më e fortë në futboll, Liga e Kampionëve, fillon sonte (e martë) me tetë ndeshje që janë mjaft interesante. Përballja kryesore do të zhvillohet në Paris mes kampionëve të Francës, Paris Saint-Germain dhe Juventusit. Skuadra franceze që ka superyjet botërorë në radhët e veta, si Messin, Mbappen dhe Neymarin, edhe në këtë edicion do të tentojë të realizojë synimin për ta fituar garën e cila deri tash ka qenë thuajse e pamundur edhe përkundër investimeve të mëdha që ka bërë në vitet e fundit. Në anën tjetër, Juventusit do të përpiqet të marrë më të mirën në këtë ndeshje për ta rritur motivin dhe rikthyer edhe rezultat pozitiv, pasi edhe në Serinë A në dy vjetët e fundit ka qenë jashtë garës për titull. Real i Madridit, që është kampion në fuqi, e nis mbrojtjen e titullit

GRUPI E
18:45 Dinamo Zagreb - Chelsea
21:00 FC Salzburg - AC Milan
GRUPI F
21:00 Celtic - Real Madrid
21:00 RB Leipzig - Shakhtar Donetsk
GRUPI G
18:45 Borussia Dortmund - FC Copenhagen
21:00 Sevilla - Manchester City
GRUPI H
21:00 Benfica - Maccabi Haifa
21:00 Paris Saint-Germain - Juventus

me përballjen ndaj Celticit, kurse ndeshje mjaft interesante do të jetë edhe ajo mes Sevilës dhe Manchester Cityt.



Hajrizi: Në Mitrovicë ka pritje të mëdha për edicionin e ri

MITROVICË, 5 SHTATOR - Interesimi për edicionin e ri është i jashtëzakonshëm, ndërsa pritet janë të mëdha në qytetin e Mitrovicës. Tifozët po presin me padurim garat, ndërsa "Xehetarët" janë organizatorë të kualifikimeve në FIBA Europe Cup si dhe të Superkupës Mbarëkombëtare. Kjo ka bërë që tema e basketbollit të jetë kryesore në qytetin e "Minatorëve". Basketbollisti me përvojë i Trepçës, Drilon Hajrizi, ka folur për përgatitjet. "Kemi filluar me kohë dhe deri më tani nuk kemi pasur ndonjë problem. Kemi zhvilluar edhe disa ndeshje miqësore që të jemi sa më të gatshëm për edicionin e ri. Po ashtu klubi ka bërë disa përf forcime që të jemi sa më konkurrues për edicionin e ri", ka thënë Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së. Mitrovicasit edicionin e kaluar fituan Kupën dhe ishin finalistë të "play-off"-it. Ky ishte trofeu i parë pas një dekade. "Klubi ka bërë një punë të madhe dhe kjo u kurorëzua



me trofeun e Kupës, që ishte shumë i rëndësishëm për të gjithë në qytetin e Mitrovicës. Shpresojmë se do të kemi paraqitje sa më të mira në të gjitha garat që do të marrim pjesë. Superliga do të fillojë pas disa ditësh dhe po përgatitemi që të jemi gatë për garat e elitës", ka shtuar basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës. "Xehetarët" për herë të parë do të marrin pjesë në FIBA Europe Cup, konkretisht në kualifikimet e kësaj

gare, që do të zhvillohen pikërisht në Mitrovicë nga 27 deri më 30 shtator. "Kjo është hera e parë që luajmë në këtë garë dhe zhvillohet në 'shtëpinë tonë'. Ky është një motiv më i madh dhe shtesë për ne. Shpresojmë në paraqitje të mirë, edhe pse nuk do të kemi lehtë", theksoi Hajrizi. Trepça në çerekfinale përballet me BC Gottingen, ndërsa në xhiron e parë të Prince Caffë Superligës do të ndeshet me Ponte Prizrenin.

Alush Gavazaj, 'ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës" pas çdo xhiroje në elitë. Çmimi i më të mirit në javën e pestë i ka takuar

futbollistit të FC Malisheva, Alush Gavazaj. Komisioni vlerësoi se Gavazaj ishte më i merituari që skuadra e tij realizoi fitore si mysafire kundër Trepçës '89. Goli i parë i Alush Gavazaj është realizuar me

mjeshtri e që rrallëherë shihet në futbollin tonë, teksa paraqitja e tij gjatë tërë ndeshjes ishte në nivel të lartë. "Ky është një çmim shumë i rëndësishëm për mua dhe për rikthimin tim në Superligën e Kosovës.

Shpresoj që ky është vetëm një fillim i mbarë për ecurinë e mëtutjeshme të kampionatit. Besoj se ky çmim do të më shërbejë mua dhe skuadrës për një kampionat sa më të mbarë", ka thënë Gavazaj.



Hamiltoni: Më dukej sikur përjetova sërish makthin e Abu Dhabit

LONDËR, 5 MARS - Lewis Hamiltoni u rendit i katërti në garën e zhvilluar ditën e diel në Holandë. Një garë ku Mercedesi kishte një strategji të mirë me pilotët e saj, por që u prish 20 xhiro nga fundi, nga hyrja në pistë e makinës së sigurisë. Kjo

penalizozi Hamiltonin, që kryesonte garën, por kishte goma të mesme, ndërsa Verstappeni montoi gomat e buta. Dhe për holandezin e Red Bullit parakalimi ishte i thjeshtë, që në momentin që iku makina e sigurisë. E njëjta situatë si me

garën e fundit të sezonit të kaluar në Abu Dhabi. "Isha i inatosur, pasi për një moment ishte njësoj sikur po përjetoja sërish garën e Abu Dhabit. Niveli i adrenalinës ishte i lartë dhe u zhgënjeva disi", ka thënë Hamiltoni. "Gjithsesi, duhet ta

shohim anën pozitive, që ishim kompetitivë dhe kishim një strategji fituese. Pa makinën e sigurisë do të kishim fituar", ka shtuar Hamiltoni që u parakaluar edhe nga Leclerc e Russell, duke mos u ngjitur dot në podium.



Berisha: Jemi gati për edicionin e ri

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Skuadrat e elitës së meshkujve po vazhdojnë përgatitjet para fillimit të edicionit të ri, ndërsa Prince Caffè Superliga do ta fillojë fundjavën e ardhshme. "Bardhekaltrit" janë duke u stërvitur intensivisht nën urdhrat e trajnerit të rikthyer Ekrem Memnun. Te kryeqytetasit është rikthyer edhe Dardan Berisha, i cili ka folur për përgatitjet. "Deri më tani kanë shkuar shumë mirë. Kemi zhvilluar disa ndeshje përgatitore, ndërsa atmosfera është e mirë. Po japim më të mirën e mundshme para fillimit të edicionit, që është shumë afër", është shprehur Berisha për faqen zyrtare të FBK-së. "Bardhekaltrit" kanë bërë disa ndryshime dhe synojnë të rikthehen te trofetë, ndërsa do të marrin pjesë edhe në kualifikimet e FIBA Europe Cup. "Jemi të motivuar për fillimin e edicionit të ri. Me përgatitjet që i kemi bërë jemi gati dhe shpresojmë në paraqitje të mira në



të gjitha garat që do të marrim pjesë", ka shtuar kapiteni i Kosovës.

Prishtina në FIBA Europe Cup është kualifikuar në gjysmëfinale, ku e pret fituesin e ndeshjes BC Kalev Cramo dhe Cedevita Junior. "Këtë vit Superliga do të jetë shumë interesante, pasi edhe

skuadrat e tjera janë përforcuar dhe do të jetë një kampionat shumë i luftuar dhe rivalizues. Edhe garat janë të rëndësishme për ne. Sigurisht synojmë paraqitje të mira", ka nënvizuar Berisha. Sigal Prishtina ndeshjen e parë në elitë e zhvillon ndaj Pejës në kryeqytet.

Ish-drejtori i Ferrarit flet për gjendjen Schumacherit

PARIS, 5 SHTATOR - Që nga ai aksident i frikshëm në dhjetor të vitit 2013, lajmet rreth gjendjes së Michael Schumacherit nuk kanë munguar. Së fundmi ai që ka reaguar është shoku i tij më i mirë, Jean Todt, i cili ka një tjetër lajm për fansat e pilotit gjerman. Ish-drejtori i Ferrarit dhe mik i ngushtë i "mbretit" të Formulës 1, Todt, është një nga të paktit persona jashtë familjes Schumacher që mund të hyjë dhe ta vizitojë pilotin gjerman. Ai kurrë nuk ka munguar të japë lajme rreth gjendjes së Schumacherit dhe kësaj radhe është shprehur se legjenda e Formulës 1 është në duar shumë të sigurta. "Jam i lumtur që fansat, jo vetëm në Gjermani, por në të gjithë botën, mendojnë kaq shumë për të. Njerëzit po më pyesin kaq shumë për Michaelin. Fansat duhet të dinë që ai është në duart më të sigurta të mundshme, në gjendjen më të mirë që mund të ishte, i rrethuar nga ata që e duan", u



shpreh Todt. "Për sa kohë të jem gjallë unë do ta vizitoj atë. Disa herë ne e shikojmë njëri-tjetrin tri herë në javë, disa herë të tjera nuk takohemi për një muaj. Ata janë

miqtë e mi dhe ne jemi në kontakte të vazhdueshme. Unë do të bëj çfarëdo gjëje që kam mundësi për familjen Schumacher", përfundoi ish-drejtori i Ferrarit.

SHKURT

KH Besa fiton turneun 'Jeton Tërstena - Tota'

Besa Famgas e ka fituar turneun memorial "Jeton Tërstena - Tota". Turneu kushtuar dëshmorit Jeton Tërstena është zhvilluar për dy ditë në Vushtrri. Në finale, të dielën, Besa e Pejës e mposhti Trepçën me rezultat 35:19. Rezultati pas pjesës së parë ishte 20:8. Ndërkohë për vend të tretë u takuan Vushtrria e Prishtina. Me një gol dallim, 31:30, fitoi Prishtina. Skuadra prishtinase ishte në epërsi 17:13 pas pjesës së parë. Ky turne u ka shërbyer skuadrave për ta parë formën në prag të fillimit të edicionit të ri të Superligës së Kosovës në hendboll.

Mulleri: Interi ekip i fortë, do të jetë një ndeshje e rëndësishme

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Thomas Muller, po pret me padurim një ndeshje të rëndësishme dhe vendimtare në Ligën e Kampionëve. Interi do ta presë të mërkurën në "San Siro" Bayernin në ndeshjen hapëse të grupeve. Pas barazimit zhgënjës të Bayern Munichit ndaj Union Berlinit, Mulleri dha mendimin e tij për sfidën ndaj zikaltërve. "Shpresoj për një rezultat më të mirë se kundër Unionit. Kjo është e sigurt. Do të jetë një ndeshje shumë e rëndësishme dhe vendimtare për të dyja skuadrat. Në një fazë grupore si kjo, loja hapëse është thjesht shumë e rëndësishme për moralin dhe për rrugëtimin në këtë turne. Unë kam qenë në gjendje të luaj disa herë në San Siro. Nuk është stadium më modern, por unë isha atje si spektator si fëmijë dhe jam ende shumë i impresionuar nga historia", ka thënë Muller.

Nice paraqet Barkleyn

Ross Barkley karrierën do ta vazhdojë në Ligën 1 të Francës. Nice njoftoi zyrtarisht për nënshkrimin me mesfushorin anglez. Madje Barkley u paraqit para tifozëve në "Allianz Riviera", pak para fillimit të ndeshjes Nice - Monaco. Klubi francez nuk ka bërë me dije për kohëzgjatjen e kontratës së 28-vjeçarit. Megjithatë, dihet se ish-mesfushori i Evertonit te Nice ka kaluar si futbollist i lirë. Ross Barkley në verën e këtij viti e kishte shkëputur kontratën me Chelsea.

Pensionohet Badstuberi

Holger Badstuber thotë mjaft. Ish-mbrojtësi i njohur i Bayern Munchenit është larguar nga futbolli. "Fansa të dashur, pas 13 vjetësh si futbollist profesionist, unë deklaroj fundin e karrierës time si lojtar aktiv. Me 31 ndeshje në kombëtaren gjermane, prania në Kupën e Botës dhe Kampionatin Evropian, gjashtë tituj kampion, katër Kupa, triumfi në Ligën e Kampionëve, Superkupë dhe tre Superkupa, mund të them që kam pasur një karrierë të suksesshme", ka shkruar Badstuber. 33-vjeçari nuk ka qenë vetëm pjesë e "bavarezëve", por ka mbajtur veshur edhe fanellën e Luzernit dhe Stuttgartit.

Fury, Joshuas: Po të jap mundësinë të kthehesh, nëse jo do të zgjedh tjetër oponent

Tyson Fury ka bërë një veprim të papritur, duke i kërkuar duel boksierit britanik, Anthony Joshua. "Gypsy King" ka publikuar një video në rrjetin social "Twitter", duke i bërë thirrje

Joshuas që t'i përgjigjet për një duel të mundshëm. Fury ka thënë se nëse AJ nuk pranon të duelojë, atëherë ai do ta njoftojë kundërshtarin e radhës. "Mendoj se të gjithë e dini se brenda pak muajve do

të duelojë përsëri. Por para këtij dueli, dua të bëj këtë, për çdo rast. Anthony Joshua, e di se sapo ke humbur ndaj Usyk dhe je pa tituj, por po ta jap mundësinë të përballësh për titujt e WBC në muajt e

ardhshëm", ka thënë Fury. "Ti sapo bërë 12 runde dhe je në formë të mirë. Po të jap disa muaj kohë, nëse je i interesuar, më trego. Nëse jo, unë do të zgjedh kundërshtar tjetër. Faleminderit!", ka

shtuar ai. Fury dhe Usyk duket se nuk do të përballen për unifikimin e titujve. 'Gypsy King' dëshiron luftën mes britanikësh për të përmblytur gjithçka.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

